

INVESTIMI

Kryebashkiaku Mziu inspekton punimet në rrugën "Gurrë" në lagjen 2 Bathore



FAQE 6

SHËRBIME


Synimi kryesor i punës së Drejtorisë së Transportit, shërbimi ndaj komunitetit



FAQE 4

DREJTORIA E FINANCËS

Rritje e të ardhurave të Bashkisë 15% më shumë në vitin 2017 në krahasim me 2016-ën



FAQE 5

VLERËSIMI

Veprimtaria e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kamëz, performancë pozitive në vazhdimësi

FAQE 5



Gazetë e Bashkisë Kamëz

KAMZA

E përdyjavshme
 Nr. 210 janar 2018
 Çmimi 20 lekë
 drmediakamez@gmail.com
 www.kamza.gov.al

Bashkëpunimi ndërkombëtar

AMBASADORI ÇEK JAROSLAV LUDVA, MBËSHTETJE PËR PROJEKTET E BASHKISË PËR PARANDALIMIN E PËRMBYTJEVE

FAQE 2

Frymë bashkëpunimi dhe premtuese për zhvillimin e qytetit në takimin e kryebashkiakut Mziu me ambasadorin e Zvicrës

Faqe 2

Bursat për studentët, Ministria e Arsimit e nis 2018-ën me një tjetër diskriminim ndaj qytetarëve të Kamzës

Faqe 8

Përfundojnë punimet te rruga pranë gjimnazit "Isa Boletini", një investim me rëndësi për komunitetin

Faqe 7

Koordinim i shkëlqyer i qytetarëve të Kamzës me shërbimet e ofruara të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve

Faqe 3



Kryebashkiaku Mziu viziton Mitrovicën, ndërsa takon në Prishtinë edhe zv.kryeministrin e Kosovës Bexhet Pacolli

FAQE 2



NË BRENDËSI

10-vjetori i krijimit të Drejtorisë së Koordinim-Zhvillimit, suksese në marrëdhëniet ndërkombëtare të Bashkisë Kamëz

FAQE 5

Bashkia, bashkëpunimi i frytshëm me donatorë të ndryshëm për realizimin e projekteve në infrastrukturën arsimore

FAQE 8

Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, projekte të gatshme në listëpritje për financim

FAQE 4

Bashkëbisedim në kuadrin e hartimit të planit social në Bashkinë Kamëz

FAQE 8

Kamza zhvillon për herë të parë fazën përgatitore në Turqi, falë mbështetjes së kryebashkiakut Mziu

FAQE 8



Ambasadori çek Jaroslav Ludva, mbështetje për projektet e Bashkisë Kamëz për parandalimin e përmbytjeve

Kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në një takim pune në zyrën e tij ambasadorin e Republikës së Çekisë, akredituar në Shqipëri, z. Jaroslav Ludva. Në takim u diskutua për mbështetjen që Bashkia Kamëz mori nga ambasadori në kuadrin e bashkëpunimit institucional për situatën e përmbytjeve.

Pasi bëri një rezumë të përgjithshme për situatën e përmbytjeve në territorin e Kamzës, kryebashkiaku Mziu e informoi ambasadorin çek për punën e bërë nga Bashkia në investimet e vazhdueshme në infrastrukturë, sidomos në investime që kanë të bëjnë kryesisht me mbrojtjen ndaj përmbytjeve, sidomos në pika kritike të territorit. Edhe pse Bashkia ka bërë investime të shumta në këtë drejtim, ku edhe gjatë reshjeve të fundit që shkaktuan përmbytje të mëdha, Bashkia Kamëz në mënyrë emergjente investoi rreth 300-400 milionë lekë të reja për t'i ardhur në ndihmë familjeve që pësuan përmbytje të rënda.



Janë dërguar rreth 140 projekte për financim, por qeveria shqiptare nuk ka financuar asnjë prej tyre. Të tilla diskriminime kanë ndodhur në vazhdimësi si në financim të shkollave, kopshteve, çerdheve, qendrave



sociale, edhe në infrastrukturë Bashkia Kamëz është e vetmja njësi e qeverisjes vendore që nuk është mbështetur për asnjë moment kjo qeveri. Të ndodhur përpara këtyre fakteve, kryebashkiaku Mziu kërkoi nga ana e ambasadorit të Republikës Çeke të akredituar në vendin tonë të mbështesë me financime projektet

tashmë të gatshme nga ana e Bashkisë Kamëz. Ambasadori i Republikës Çeke siguroi mbështetjen e plotë të financimit të projekteve emergjente që ka Bashkia Kamëz për parandalimin e përmbytjeve në këtë zonë. Gjithashtu në diskutimin e tij kryebashkiaku Mziu e ftoi ambasadorin për të bërë të mundur sjelljen e biznesmenëve çekë në Kamëz për të sjellë pjesë të investimit të tyre, pasi Kamza ka një pozicion gjeografik mjaft të favorshëm për bizneset, duke theksuar se Shqipëria është një vend mjaft tërheqës për turistët, sidomos ata çekë që çdo vit e më tepër janë të pranishëm në vendin tonë. Kryebashkiaku Mziu e nderoi ambasadorin çek, z. Jaroslav Ludva, me certifikatën "Mirënjohja e Qytetit" për iniciativën dhe kontributin e ndërmarrë në ndihmë të Bashkisë dhe banorëve të Kamzës gjatë situatës së përmbytjeve, si dhe vazhdimin e marrëdhënieve ndërinstucionale dhe zhvilluese në dobi të qytetarëve dhe qytetit.

Frymë bashkëpunimi dhe premtuese për zhvillimin e qytetit në takimin e kryebashkiakut Mziu me ambasadorin e Zvicrës



drejtëpërdrejtë i shërbimit qytetar. Ka më shumë se 4 vite që Bashkia vuan praktikën e financimeve nga qeveria qendrore si një mjet diskriminues ndaj qytetarëve të Kamzës. Një problematikë mjaft e thellë mbetet delegimi i kompetencave sipas ligjit për organizimin e qeverisjes vendore në bazë të reformës territoriale. Bashkia Kamëz është e vetmja qeverisje vendore në vend që nuk i gëzon këto të drejta", - informoi z. Mziu.

Një problem mjaft themelor mbetet për Bashkinë problemi i përmbytjeve të ndodhura në vazhdimësi, për shkak të pozicionit gjeografik që ajo ka edhe përmbytjet e muajve nëntor-dhjetor 2017 sollën dëme katastrofike në territorin e Bashkisë Kamëz si në objekte familjare, biznese, shkolla, kopshte fëmijësh etj. Mbetet problem financimi i dy kolektorëve kryesorë që do të bënte të mundur zgjidhjen përfundimtare të përmbytjeve në territorin e Bashkisë Kamëz.

Vetëm në këtë periudhë të vitit të kaluar për të minimizuar këto dëme Bashkia Kamëz financoi rreth 4 milionë lekë të reja, duke detyruar ndryshimin e buxhetit duke sjellë pasoja të dukshme në investime dhe shërbime për qytetarët. Prandaj kryebashkiaku Mziu i kërkoi z. ambasador mbështetjen e Bashkisë Kamëz me financime për projektet e dy kolektorëve kryesorë si dhe lobimin ndaj qeverisë shqiptare për financimin dhe miratimin e një plani urbanistik për Bashkinë Kamëz.

Ambasadori vlerësoi lart aktivitetin e kryebashkiakut Mziu duke theksuar si një kryetar mjaft aktiv dhe plot energji për punët që ka bërë dhe vazhdon të bëjë në të mirë të komunitetit.

"Ne, - theksoi ambasadori, - jemi duke përgatitur strategjinë kombëtare zvicerane, ku ndër të tjera në këtë strategji përfshihet ndihma ndaj bashkive të vendit tuaj. Kemi interes për demokracinë vendore.

Lidhur me kërkesën e dytë për financimin e dy kolektorëve për zgjidhjen e problemeve të përmbytjeve, ne po do të kemi së shpejti gati projektin "Bashki të forta", ku ne shpresojmë që Kamza do të jetë pjesë e këtij projekti", - përfundoi në fjalën e tij ambasadori zviceran.

Ndërkaq, kryebashkiaku Mziu kërkoi shtrirjen e bashkëpunimit për të bërë të mundur binjakëzimin me një ndër bashkitë e Zvicrës, si dhe ftesën për biznesmenë zviceranë për të investuar në Kamëz, për shkak se është një zonë në zhvillim, atraktive jo vetëm për qytetarët e Kamzës dhe Shqipërisë, por edhe për ata të Ballkanit e të Evropës mbarë.

Në këtë takim kryebashkiaku Mziu shoqërohej nga zv.kryetari i Bashkisë dhe njëkohësisht drejtori i Kabinetit si dhe nga drejtorja e Koordinim-Zhvillimit dhe Projekteve. Takimi u karakterizua nga një frymë e thellë bashkëpunimi dhe premtuese për zhvillimin e qytetit.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu vizitoi Mitrovicën bashkë me kolegë të tjerë të shtatë bashkive të Shqipërisë



Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka vizituar Mitrovicën bashkë me një delegacion të përbërë nga shtatë kryetarë të tjerë të bashkive të Shqipërisë. Ky delegacion është pritur nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, z. Agim Bahtiri. Pasi shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë, kryetari Bahtiri i njohu kryetarët e bashkive të Kukësit, Pogradecit, Lezhës, Përmetit, Kamzës, Burrelit, Matit dhe Selenicës me gjendjen e përgjithshme në Mitrovicë. Ai tha se falë përkushtimit e maturisë së qytetarëve para së gjithash dhe angazhimit të drejtuesve të Komunës, si dhe të faktorëve tjerë të sigurisë, gjendja në Komunën e Mitrovicës, e cila kishte probleme dhe sfida të jashtëzakonshme që pas përfundimit të luftës, sot është e qetë dhe normale. "Në katër vitet e kaluara kemi qenë të angazhuar maksimalisht në stabilizimin e plotë të gjendjes politike e të sigurisë, ku edhe kemi arritur sukses. Në fund të mandatit të kaluar dhe tani në fokus të angazhimeve tona është zhvillimi ekonomik i komunës, ku edhe kemi arritur rezultate. Në Frashër po ndërtohet Zona industriale ku do të vendosen 300 biznese, disa prej të cilave kanë mbaruar objektet, kurse të tjerat janë në ndërtim e sipër. Kur kësaj t'i shtojmë edhe zgjidhjen e problemeve të Treçës së shpejti, atëherë mund të themi se Mitrovicës po i kthehet perspektiva e zhvillimit ekonomik", - tha ndër të tjera z. Bahtiri. Kryetarët e bashkive të qyteteve të Shqipërisë i njohën kreun e Komunës së Mitrovicës me gjendjen në bashkitë që ata i drejtojnë, duke u shprehur të gatshëm që të bashkëpunojnë dhe binjakëzohen me këtë Komunë. Ndërkaq, ata vizituan urën kryesore mbi lumin Ibër si dhe sheshet e qendrës së qytetit. Në vazhdim ata vizituan edhe objektin e ri të ndërtuar për sport e rekreacion-OMNI-sport dhe fabrikën e kërpudhave në Gushafç. Gjatë vizitës së tij në Kosovë, kryebashkiaku Mziu pati një takim edhe zv.kryeministrin e parë dhe ministër i Jashtëm, z. Bexhet Pacolli.

Takim i kryebashkiakut Mziu me ambasadorin e Arabisë Saudite, z. Fayez Altemyat, i cili premtoi mbështetje për investime

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ka zhvilluar një takim me ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fayez Altemyat. Ky takim, i cili u zhvillua në mjediset e Ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë, ishte në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstytucional si dhe për situatën e përmbytjeve të krijuar nga reshjet e datës 30 nëntor 2017.

Kryebashkiaku Mziu i bëri një analizë përshkrimi të ndryshimeve thelbësore të qytetit të Kamzës dhe zhvillimeve të shumta të tij. Gjithashtu, kryebashkiaku Mziu i bëri të qartë ambasadorit situatën e rëndë që kaloi Kamza gjatë përmbytjeve. Po ashtu, z. Mziu ftoi ambasadorin e Arabisë Saudite për një vizitë në qytetin e Kamzës, ftesë të cilën e Ambasadori e pranoi me kënaqësi dhe premtoi se do ta realizojë në një kohë sa më të shpejtë. Gjatë takimit u diskutua edhe për bashkëpunime të gjëra në fusha të ndryshme, si në investime nga investitorë arabë, si dhe në kultet e ndryshme fetare. Nga ana e kryetarit të Bashkisë, z. Mziu, u kërkua që ambasadori të bëjë të mundur nga negociimin me qeverinë e shtetit të tij financimin e dy projekteve të gatshme për investim në eliminimin e përmbytjeve në territorin e Bashkisë Kamëz, që iu dorëzuan personalisht ambasadorit, ku nga ana e tij z. Mziu u sigurua nga ambasadori se do të llobojë pranë qeverisë që të bëhet i mundur financimi i tyre. Gjithashtu, ambasadori premtoi se do të shikojë të gjitha mundësitë për të bërë të mundur ndihma humanitare si dhe investime në projekte të cilat ia paraqiti z. Mziu.

Ambasadori polak në Shqipëri, Karol Bachura, pas takimit me kryebashkiakun Mziu, mbështetje për projektet e Bashkisë Kamëz

Ambasadori polak në Shqipëri, Karol Bachura, pas takimit me kryebashkiakun Mziu, mbështetje për projektet e Bashkisë Kamëz

Ambasadori i Polonisë në Shqipëri, Karol Bachura, ka premtuar mbështetje për projektet e Bashkisë Kamëz. Kjo është konfirmuar gjatë takimit që kryebashkiaku Xhelal Mziu pati me z. Bachura në mjediset e Ambasadës Polake në Tiranë. Në kuadrin e bashkëpunimit me faktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë, z. Mziu po vijon takimet me institucione të ndryshme, me qëllim gjetjen e mbështetjes për realizimin e projekteve emergjente dhe jetike për banorët e Kamzës. Projekte të tilla janë ato për parandalimin e përmbytjeve në raste reshjesh të dendura, siç ishin ato të 30 nëntorit 2017. Kryebashkiaku Mziu e njohu ambasadorin Bachura për situatën e krijuar nga këto përmbytje, si dhe me zhvillimet në qytetin e Kamzës. Ai i bëri me dije z. Bachura se Bashkia i ka të gatshme projektet për ndërhyrjen në zonat problematike. Gjithashtu, z. Mziu tha se vlera e investimeve për ndërhyrjen në tre kolektorë kryesorë, si në Frutikuturë, Valias dhe Paskuqan, e kalon kapacitetin financiar të Bashkisë. Për këtë nevojë, institucioni i Bashkisë u është drejtuar institucioneve shtetërore përgjegjëse për financimin e tyre, por deri më sot përgjigjja ka qenë një heshje totale kundrejt këtyre kërkesave. Prioritet i Bashkisë Kamëz për menaxhimin e situatave emergjente të shkaktuara nga reshjet e fundit janë dy projektet e miratuara për sistemimin e ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura në zonën Bathore, Frutikuturë dhe Valias. Rëndësia imediate për investim në kolektorët kryesorë është për t'i paraprirë përsëritjes së këtyre rasteve dhe për neutralizimin e përmbytjeve në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Bashkisë Kamëz. Vlen për t'u theksuar se këto projekte mbrojnë nga rreziku i përmbytjeve rreth 20 mijë familje. Konkretisht, projektet janë:

1. Kolektori që mbledh ujërat nga ish-komuna Zall-Herr deri në derdhjen e lumit Tirana, me gjatësi 4565 m, që përshkon rrugën "Demokracia", rrugën "Bashkim Gazidede", zonën e Frutikuturës deri në lumin Tirana.

2. Kolektori tjetër fillon në rrugën "Skënderbeu" dhe përshkon zonën e Valiasit, me gjatësi totale 3795 m, duke përshkuar rrugët "Kujtesa", "NATO", "Ballsh", "Harku i Triumfit" deri në lumin Tirana. Bashkia Kamëz, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka gati projektet për financim në realizimin e investimit.

Bashkia Kamëz nis punën për vitin 2018

Janar 2018
GAZETA KAMZA

3



Sapo ka hyrë viti 2018 dhe Bashkia Kamëz e ka nisur punën për përmbushjen me sukses të objektivave për këtë vit kalendarik. Shërbimet në sportelet e One Stop Shop-ëve në Kamëz, Bathore dhe Paskuqan kanë pritur me qindra qytetarë për të shërbyer sipas kërkesave të paraqitura. Ky vit është nisja e një zbatimi të një programi mjaft ambicioz si në investime ashtu edhe në shërbime. Do të jetë një vit që qytetarët e Kamzës do të jenë përfitues të rreth 60 investimeve me kapitale themelore, të rëndësishme në përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, por edhe më gjerë, të përmirësimit të jetesës së tyre. Këto investime do të jenë krejtësisht të mbuluara nga buxheti i Bashkisë për vitin 2018.

Projekte të rëndësishme do të zbatohen edhe në fushat e pastrimit dhe gjelbërimit, të arsimit, kulturës dhe sportit.

Por do të ketë dhe projekte konkrete për kopshtet, çerdhet dhe terrenet argëtuese për fëmijët. Do të zbatohen projekte mjaft të ndjeshme për shtresat në nevojë me karakter të thellë social. Nuk do të lihet jashtë vëmendjes edhe kujdesi që institucioni do të ketë për moshat e treta.

Bashkia do të ketë projekte ambicioze me ndikim të madh në ujësjellës-kanalizime si dhe do të jetë përfituese e mjaft investimeve të huaja nëpërmjet projekteve konkurruese etj.



Puna e bërë në vitin 2017, Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit e Treg, e gatshme për shërbimet që ofron për qytetarët



Gjatë vitit 2017, Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit e Treg në Bashkinë Kamëz ka qenë e gatshme dhe e angazhuar maksimalisht për të ofruar shërbime cilësore për qytetarët. Në analizën e zhvilluar për punën në vitin që kaloi, u theksua se kjo ndërmarrje ka shtrirë shërbimin, duke mbuluar me pastrim

gjithë territorin e Kamzës, të Bathores dhe Paskuqanit.

Është bërë grumbullimi dhe transportimi e mbeturinave deri në venddepozitim; janë zgjidhur në kohë reale të gjitha ankesat që ka pasur komuniteti; si dhe janë plotësuar objektivat e vënë nga analiza e vitit 2016. Për

shkak të situatës së krijuar nga përmbytjet, gjatë nëntorit dhe dhjetorit 2017, Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit me të gjithë punonjësit sipas sektorëve u gjend pranë familjeve të përmbytura, duke ndërmarrë aksione të vazhdueshme në pastrimin e kolektorëve. Gjithashtu, edhe pastrimin e inerteve, pasi qytetarë të papërgjegjshëm shkarkojnë pranë pikave të mbeturinave, si dhe ka ndërmarrë aksione të vazhdueshme për pastrimin e qytetit.

Gjatë vitit 2017 janë zëvendësuar mbi 280 pemë të llojeve të ndryshme, duke qenë se gjelbërimi mbetet një prioritet i ndërmarrjes dhe njëkohësisht edhe i Bashkisë. Në 2017-ën u planifikuan dhe u hapën gropat për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugë të reja me një numër total prej 1223 pemësh.

Ndërkaq, vazhdon mbjellja e 700 pemëve dekorative të tjera në rrugë të reja. Për pemët e mbjella është treguar një kujdes edhe për zëvendësimin e tyre, pasi disa herë qytetarë të pandërgjegjshëm i kanë thyer. Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit bën pastrimin e gjithë territorit të Bashkisë Kamëz dhe Njësisë Administrative Paskuqan; mirëmban të gjitha rrugët e trotuarët; bën transportin e të gjitha mbetjeve urbane deri në venddepozitim; mirëmban pikën e grumbullimit të mbeturinave dhe kujdeset për mirëfunksionimin e saj; kujdeset për gjelbërimin e hapësirave publike të qytetit, duke mbjellë pemë dekorative apo duke zëvendësuar pemët e dëmtuara; mirëmban varrezat dhe ofron këtë shërbim në Kamëz, Laknas, Bathore, Kodër e Kuqe dhe Babrru.

Shërbime edhe ditët e pushimeve nga ana e strukturave të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit

Strukturat e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit kanë qenë të angazhuara për të kryer shërbime si në sektorin e pastrimit ashtu edhe të mbledhjes e transportit të mbetjeve urbane edhe gjatë ditëve të pushimeve. Punonjësit e kësaj ndërmarrjeje kanë kryer të gjitha shërbimet e duhura që realizohen në përgjegjësitë e kësaj strukture, duke ruajtur ritmin dhe për më tepër kanë shfrytëzuar 24 orë për të përballuar dyfishimin e prodhimit të këtyre mbetjeve. Ky mobilizim është pjesë e punës në vazhdimësi që Bashkia Kamëz ka rritur nga viti në vit për miradministrimin dhe menaxhimin e përgjegjësive institucionale duke i kthyer ato në shërbime ndaj qytetarëve të saj. Rritja e pikave të grumbullimit të mbetjeve organike dhe joorganike ka sjellë përpara drejtuesve të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit rritjen e përqendrimit për mirorganizimin e punës në terren për të përballuar situatat në pikëgrumbullimet deri në venddepozitim. Edhe ky vit ka nisur i mbarë për këta punonjës për të pasur gjithmonë vëmendjen e duhur për të kryer shërbimet me cilësi në të gjitha ditët e vitit pa njohur asnjë pushim me qëllim përmbushjen e gjithë objektivave të planifikuar.

Drejtorja e Rajonit Bathore, përkushtim i administratës në shërbimin ndaj qytetarëve

Përkushtim i punonjësve të administratës në shërbimin ndaj qytetarëve. Kjo është theksuar gjatë analizës së Drejtorisë së Rajonit Bathore për punën e bërë në vitin 2017. Drejtorja e Rajonit Bathore ka prezantuar punë e saj 1-vjeçare në të gjithë sektorët që mbulon. Kjo drejtori ushtron aktivitetin e vet në shtatë lagjet e Bathores dhe fshatin Bulçesh, nëpërmjet shërbimeve të saj me këto zyra: Zyra e Gjendjes Civile, Zyra e Shërbimeve Publike, Zyra e Arkës, Zyra e Arkës për Taksat Familjare, Zyra e Arkës për Tarifën e Ujit, Zyra e Ndihmës Ekonomike, Zyra e Administratorit të Shërbimeve. Gjatë vitit 2017, ndër të tjera, vëmendje i është kushtuar ndërtimit të infrastrukturës, duke qenë përfituese e dhjetëra investimeve. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar pastrimit. Falë punës së bërë për vitin 2017 impakt pozitiv ka dhënë heqja e pikave të mbeturinave në rrugën "Demokracia". Gjithashtu, është punuar edhe për pastrimin e mbeturinave në KUN-të problematike që t'i paraprihet rrezikut të përmbytjeve në rastet e shirave. Është bërë furnizimi me ujë i shumicës së qytetarëve, e thënë ndryshe mbi 80% e territorit të Bathores. Gjatë ndërtimit të rrugëve të reja njëkohësisht janë lidhur kontrata të reja si dhe janë sistemuar linjat ekzistuese dhe eliminimi i ndërhyrjeve të paligjshme. Gjatë vitit që shkoi, Zyra e Ndihmës Ekonomike ka bërë studimin për gjendjen ekonomiko-sociale të zonës Bathore për të përcaktuar familjet më në nevojë ekonomike, sidomos ato me varfëri ekstreme, me qëllim përfshirjen e tyre në skemat e punësimit sezonal, kurseve të kualifikimit dhe përfshirjen në skemën e ndihmës ekonomike. Pasi ka ndjekur paraqitjen e analizës, sekretari i përgjithshëm i Bashkisë, z. Qemal Çejku, vlerësoi shërbimin korrekt në të gjithë sektorët dhe përkushtimin dhe komunikimin e me qytetarët.

Koordinim i shkëlqyer i qytetarëve të Kamzës me shërbimet e ofruara të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve



Ditët e para të fillimvitit 2018 ka pasur një reagim të menjëhershëm të qytetarëve të Bashkisë Kamëz për të realizuar pagesat e faturave të ujit. Në kuadrin e një platforme favorizuese që Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Kamëz dhe të reformës së politikave të përdorimit eficient të ujit të pijshëm, ka pasur një dyndje në sportelet e shërbimeve për pagesën e faturës së ujit nga ana e qytetarëve të Kamzës, Bathores dhe Paskuqanit. Bashkia ka marrë një përgjegjësi të madhe të organizimit të shërbimeve në sportele për të ulur ndjeshëm krijimin e radhëve të zgjatura, duke krijuar grupe shërbimi punonjësish për të shërbyer me orë të zgjatura gjithmonë në shërbim të komunitetit. Ndikimi i këtyre dyndjeve vjen edhe nga shpërndarja e informacionit të grupeve të punës në terren, i cili është transmetuar në çdo familje, subjekt privat apo publik. Performanca financiare e kësaj ndërmarrjeje ka arritur të përmirësohet ndjeshëm dhe do të ketë ndikim në konvertimin e tyre në shërbime të drejtpërdrejta për qytetarët. Edhe pse ka pasur një fluks të jashtëzakonshëm nga ana e qytetarëve të Kamzës për të kryer pagesat, është një thirrje për mbarë subjektet për të koordinuar marrëveshjet me Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve për të marrë shërbimet në përmirësim, qoftë për lidhjet e reja, qoftë për rregullimin e debisë së pashlyer, qoftë edhe për lidhjet e paligjshme deri më 31 janar 2018. Ky koordinim sjell pa dyshim një rezultat të përbashkët për një qëllim të rëndësishëm.



Synimi kryesor i punës së Drejtorisë së Transportit në Bashkinë Kamëz, shërbimi ndaj komunitetit

Gjatë analizës së Drejtorisë së Transportit, Lejeve, Licencimeve dhe IT për vitin 2017, ku ishte i pranishëm kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu, u theksua se dy shtyllat kryesore të punës së kësaj drejtorie janë shërbimi ndaj komunitetit, që përfshin mbulimin e transportit të udhëtarëve, licencimin, certifikimin e mjeteve të transportit, lejet e ushtrimit të veprimtarisë në fushën e transportit; si dhe realizimi i të ardhurave. Drejtoria e Transportit ka bërë një punë voluminoze në kryerjen e detyrave në vitin 2017. Me krijimin e bazës së të dhënave të mjeteve të licencuara dhe masat e marra nga drejtoria për evidentimin e subjekteve që operojnë në fushën e transportit të mallrave dhe të udhëtarëve, zbatimi i paketës fiskale dhe konvertimi i saj për çdo detyrim dhe uljen e informalitetit u arrit të realizohet plani në lejet e transportit për mallra dhe udhëtarë.

Zbatimi i studimit të transportit publik urban bëri të mundur mbulimin e 90% të territorit të



Bashkisë Kamëz me këtë shërbim; uljen e kostos së udhëtimit për qytetarët, duke përdorur sistemin e aboneve; rritjen e të ardhurave për Bashkinë (nga 7 linja me një numër mjeteve 54, sot operohet në 9 linja me numër mjeteve 88); vende pune të reja për komunitetin, duke u rritur 39% numri i punonjësve; autobusë më komodë sipas kriterëve teknike në mbështetje të udhëtimit; uljen e ndotjes mjedisore. Politikat e ndjekura nga Bashkia kanë ndikuar në uljen e informalitetit gjë që ka sjellë impakt pozitiv në shërbim dhe



rritjen e të ardhurave. Bashkia Kamëz, përmes politikave në shërbim të komunitetit, plotëson nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për transport udhëtarësh. Vlen të përmendet zbatimi i studimit të transportit urban dhe riorganizimi i të gjitha linjave qytetase, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse ushqyese me qëllim shërbimin e transportit për qytetarët sa më afër qytetarëve. Ky studim bëri të mundur për vitin 2017 të bëhej licencimi për të gjitha linjat e transportit publik urban në Bashki. Ky studim pati impakt pozitiv, qoftë në shërbimin

që kryhet në transportin e udhëtarëve, po kështu edhe në realizimin e planit të të ardhurave. Ndërkaq, synimet për rregullimin e transportit për vitin 2017 është studimi i sistemit të sinjalistikës rrugore për gjithë sistemin rrugor të Bashkisë Kamëz; lufta ndaj informalitetit; ulja e debitorëve në maksimumin e mundshëm; lirimi i hapësirave publike të parkingjeve dhe vënia në dispozicion e tyre për komunitetin; studimi për organizimin e stacionimit të shërbimit taksi etj.

Vlen për t'u përmendur edhe puna e sektorit të IT-së gjatë vitit 2017, periudhë në të cilën u punua shumë në projektin e WebGIS, në bashkëpunim me USAID-in. Pas referimit të analizës nga ana e drejtorit të Transportit, kryebashkiaku Xhelal Mziu falënderoi punonjësit e saj për punën e bërë, duke dhënë edhe disa rekomandime, të cilat kanë të bëjnë, para së gjithash me zbatimin e ligjit, si dhe me zhdukjen e informalitetit dhe rritjen e të ardhurave.

Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, projekte të gatshme në listëpritje për financim



Është zhvilluar analiza e punës së Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për vitin 2017, gjatë së cilës janë dhënë edhe vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse të kryetarit të Bashkisë, z. Xhelal Mziu. Ndër të tjera, gjatë prezantimit të analizës u theksua se treguesit që ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin urban janë infrastruktura rrugore, infrastruktura nëntokësore, rivitalizimi i ambienteve rekreative, zhvillimi i kapacitetit të planifikimit strukturor si baza për zhvillimin pozitiv të qytetit. Ndërkaq, u theksua se Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit ka projekte dhe projektide të gatshme në listëpritje për financim, të cilat janë riparë dhe rillogaritur sipas përditësimit të manualit dhe zhvillimeve të fundit dhe standardeve të kërkuara në përputhje me cilësinë dhe mënyrën e projektimit. Është kërkuar herë pas here financimi i këtyre projekteve nga ministritë përkatëse sipas formularit përkatës duke i ndarë prioritetet e rëndësive të secilit investim sipas karakterit ndërrajonal, rajonal, urban dhe interurban. Megjithatë, edhe pse janë projekte të hartuara sipas standardeve më të larta, qeveria nuk ka marrë parasysh asnjë kërkesë për financim. Vend kryesor në punën e vitit 2017 zënë realizimet e investimeve: në infrastrukturën rrugore dhe rrjetin e kanalizimeve. Numërohen mbi 50 projekte vetëm për vitin 2017. Ndërkohë, ka edhe projekte në zbatim e sipër, çfarë do të thotë që puna nuk ndalet për realizimin e investimeve. Gjithashtu, gjatë vitit 2017 një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe investimet e emergjencës. Një detyrë tjetër shumë e rëndësishme e Drejtorisë së PKZHT-së është edhe përgatitja e projektzbatimeve për buxhetin e vitit 2018. Për këtë janë ngritur grupet e punës në terren, janë bërë matjet e duhura, rievitimet e nevojshme dhe me korrektesë janë përgatitur preventivat, specifikimet teknike, relacionet dhe projektet e duhura sipas investimeve përkatëse. Hedhja në programin webgis të informacioneve në lidhje me ndërtesat dhe parcelat ka qenë një tjetër punë voluminoze e Drejtorisë së Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, projekt ky në bashkëpunim me USAID-in.

Pas prezantimit të analizës, kryebashkiaku Mziu tha se viti 2017 ishte një vit i suksesshëm për Bashkinë, ashtu edhe për këtë drejtori, e cila luan një rol të rëndësishëm. Sipas tij, puna e kësaj drejtorie ndikon në standardin e infrastrukturës së qytetit, gjithashtu ndikon edhe në të ardhurat e krijuara nga Bashkia. Ndërkaq, në fjalën e tij kreu i Bashkisë theksoi se edhe pse ishte një vit i mbushur me investime, ka pasur projekte që kanë hasur në vështirësi gjatë zbatimit të tyre. Në këtë kontekst ai kërkoi nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit që investimet të ndiqen e të kontrollohen në mënyrë të rreptë, që nga hartimi, faza e realizimit, marrja në dorëzim, certifikimi i tyre etj. Duhet të ketë tolerancë zero ndaj çdo gjëje që nuk zbatohet nga kompanitë zbatuese të projekteve. Kjo, me qëllimin që qytetarët dhe qyteti të përfitojnë investime të cilësisë më të lartë dhe bashkëkohore.

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, arritje në veprimtarinë e saj si një njësi e organizuar dhe funksionale



Në analizën vjetore të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve ishte i pranishëm kryebashkiaku Xhelal Mziu. Në relacionin e kësaj analize u prezantua e gjithë veprimtaria e strukturës së kësaj ndërmarrjeje, e cila ishte mjaft e gjerë dhe me të gjithë komponentët e shërbimeve në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz. Gjatë vitit 2017, Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve pati arritje të dukshme në të gjithë treguesit e veprimtarisë së saj si një njësi e vetme e organizuar dhe funksionale. Kjo analizë u krye në frymën e një reflektimi të përhershëm që megjithëse nga viti në vit sjell përmirësime të dukshme si në aspektin financiar dhe në atë menaxhues, do të thotë që këto elemente janë vërtet pamjet reale që puna e kësaj ndërmarrjeje vlen të përmendet pozitivisht. Janë përfituar investime të rëndësishme në ujësjellës-kanalizime, si projekti i Bankës Gjermane për Zhvillim për furnizimin me ujë të pijshëm të gjithë abonentëve që jetojnë dhe marrin furnizime nga burimet e përhershme në territorin e Bashkisë Kamëz. Kjo e ka dhënë ndikimin e saj qysh me fazën e parë të zbatimit të projektit, i cili do të vijojë në vitet në vazhdim edhe me 3 fazat e tjera deri në përfundimin e plotë të tij. Një shërbim tjetër që ka pasur gjithashtu ndikim të fuqishëm në infrastrukturë kanë qenë edhe investimet e shumta që janë kryer në rehabilitimin e kanaleve të ujërave të ndotura. Krahas shërbimeve bazë sot ndërmarrja ka një sipërmarrje më të gjerë për të shtrirë linjat e shërbimit ndaj abonentëve dhe me elementë të tjerë të domosdoshëm për mbarë qytetarët e Bashkisë Kamëz.

Pas përfundimit të relatimit nga ana e drejtorit të kësaj ndërmarrjeje, fjalën e mori kryetari i Bashkisë z. Xhelal Mziu. Kryebashkiaku pasi vlerësoi punën e bërë gjatë vitit 2017 nga ana e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, ndaloi kryesisht çfarë duhet përmirësuar në të ardhmen.

Disa nga pikat ku kryebashkiaku Mziu i mëshoi fjalës së tij ishte kryesisht në identifikimin e të gjithë abonentëve që marrin furnizim me ujë të pijshëm dhe nuk janë të përfshirë në skemën e pagesave të detyrimeve për ujë dhe KUN. Të përmirësohen në mënyrë progresive treguesit financiarë dhe shërbimet duke vazhduar luftën pa kompromis ndaj informalitetit. Të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme situata në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz për mirëmenaxhimin e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, duke rritur dhe përmirësuar ndjeshëm e eficientë e stafit të kësaj ndërmarrjeje në çdo qelizë të saj, sidomos kontrollin e terrenit. Këto dhe shumë pika të tjera që ishin të domosdoshme për t'u marrë në konsideratë do të jenë objektiva të patjetërsueshëm, theksoi në fjalën e tij përmblylëse kryebashkiaku Mziu, duke i uruar edhe një herë të gjithë stafit të kësaj ndërmarrjeje suksese në detyrat që i presin për vitin 2018.

Analiza e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, planifikimi i fillimvitit është rritur 15% më shumë se viti paraardhës



Është zhvilluar analiza e Drejtorisë së Taksave dhe e Tarifave Vendore për vitin 2017. Gjatë analizës u theksua se për vitin 2017 në territorin e Bashkisë Kamëz ushtruan aktivitet tregtar 2924 subjekte. Krahasuar me planin e 2016-ës, në vlerë absolute planifikimi i fillimvitit është rritur, 15% më shumë se viti paraardhës. Ndërkaq, dihen tashmë kufizimet që qeveria qendrore i ka bërë pushtetit vendor në drejtim të mbledhjes së të ardhurave, konkretisht në tatimfitimin e thjeshtuar, ku nga viti në vit vjen në ulje e ardhura nga ky tatim. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat faktike të realizuara për vitin 2017 janë rreth 5% më shumë. Ky tejkalim është realizuar proporcionalisht për çdo zë të taksave, si ato të biznesit edhe ato të kategorisë familjare përjashtuar tatimfitimin e thjeshtuar. Ndër objektivat kryesorë për vitin 2018 mbetet realizimi i planit në masën 100%; zbatimi me përpikmëri i paketës fiskale; saktësim i listave të debitorëve; zbatim 100% të rekomandimeve të lëna nga auditi i brendshëm dhe i jashtëm; rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj taksapaguesve; forcimi i disiplinës fiskale në zbatimin e drejtë, të ndershëm dhe eficient të procedurave tatimore, si mjet kryesor për reduktimin e evazionit fiskal dhe krijimin e një sistemi të drejtë tatimor.

Ndërkaq, në fjalën e tij kryebashkiaku Xhelal Mziu u shpreh se Bashkia në vitin 2017 ka pasur progres për sa u përket investimeve dhe shërbimeve ndaj qytetarit e rol në këtë ka luajtur edhe Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore. Duke vlerësuar punën e bërë nga kjo drejtori, kreu i Bashkisë theksoi se sfidë për këtë drejtori për këtë vit është lufta ndaj informalitetit dhe situata debitore.

10-vjetori i krijimit të Drejtorisë së Koordinim-Zhvillimit, suksese në marrëdhëniet ndërkombëtare të Bashkisë Kamëz



Këtë vit shënohet 10-vjetori i krijimit të Drejtorisë së Koordinim-Zhvillimit të Projekteve dhe Protokollit Ceremonial në Bashkinë Kamëz. Gjatë kësaj periudhe, vien për t'u theksuar suksesi që ka pasur qyteti dhe Bashkia e Kamzës, falë punës së kësaj drejtorie. Drejtoria e Koordinimit, Zhvillimit të Projekteve dhe Protokollit Ceremonial u ngrit si drejtori në vitin 2008, me këto funksione kryesore: koordinimi i punës për ndërtimin e programeve të zhvillimit dhe hartimit të projekteve për realizimin e tyre; organizimi i korrespondencave, kontakteve dhe bashkëpunimeve në arritjen e partneriteteve dhe binjakëzimeve me bashki e qytete që janë pjesë e BE-së, atyre rajonale dhe botërore; bashkëpunimi i kësaj drejtorie me drejtoritë e tjera për marrjen e informacionit, plotësimin, përkthimin, arkivimin e një dokumentacioni të gjithanshëm, të kërkuar nga donatorë e institucione të rëndësishme ndërkombëtare për projekte zhvilluese, si Komisioni Evropian, Këshilli Evropës, USAID, UNDP si dhe institucionet qendrore; promovimi i performancës së Bashkisë jo vetëm në nivel kombëtar, por veçanërisht atë ndërkombëtar; ndjekja e axhendës së institucionit në funksion të realizimit të aktiviteteve të ndryshme, siç janë qenë ceremonitë inauguruese, pritjet e delegacioneve, aktivitetet kulturore, festive, sportive etj. Gjatë analizës së punës së bërë nga kjo drejtori në vitin 2017, u theksua se rezultatet janë të dukshme,



ashtu si për të gjitha vitet, që nga viti 2008 e këtej. Kështu, numërohen me dhjetëra binjakëzime me bashki e qytete të Bashkimit Evropian dhe më gjerë; aplikimi dhe pjesëmarrja në projekte të rëndësishme të financuara nga organizmat ndërkombëtarë si rezultat i rrjetit të binjakëzimeve të Bashkisë Kamëz. Kjo është arritur falë një platforme pune, e cila është ngritur në 4 prioritet: prioriteti për zhvillimin e projekteve; prioriteti për thithjen e investimeve të huaja; prioriteti për aplikimin e projekteve në Komisionin Evropian dhe në programe të tjera financiare; prioriteti për zgjerimin e bashkëpunimeve dhe binjakëzimeve. Ndërkaq, duhet përmendur edhe binjakëzimi më i ri i Bashkisë Kamëz, pikërisht me Bashkinë Castenaso (Kastenzazo), Bolonja, Itali, marrëveshja me të cilën u finalizua në ditët e para të vitit 2017.

Përveç sa më sipër, ka vijuar puna për aplikime në projekte dhe thirrje ndërkombëtare të reja, siç është aplikimi në programin për çmimin e KE "European Green Capital Award 2020" - "Kryeqyteti i Gjellbër i Evropës 2020"; bashkëpunimi me Qendrën për Integrim Evropian dhe Zhvillim (CEID) në kuadër të projektit "Krijimi dhe Institucionalizimi i Këshillit Rinor", mbështetur financiarisht nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe Qendra për Integrim Evropian dhe Zhvillim (CEID); projekti STAR 2 "Konsolidimi i reformës administrative dhe territoriale" - Informatzimi i One Stop Shop-it. Qëllimi i projektit konsiston në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative dhe rritjen e transparencës e llogaridhënies dhe angazhimit qytetar. Projekti është bërë i mundur nëpërmjet mbështetjes dhe bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, qeveritë e Suedisë, Italisë, Zvicrës dhe USAID-it. Mbështetja për One Stop Shop-in, në emër të projektit STAR 2, do të ofrohet nga konsorciumi "CSI Piemonte, IklubINFO, IP3 dhe Infosoft Systems", i përzgjedhur sipas procedurave prokuruese të UNDP; projekti "Bashkitë për në Evropë", i financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri për ngritjen e Zyrës Evropiane Vendore në Kamëz duke përbushur me përpikmëri, saktësi dhe në afatet e duhura kohore informacione dhe të dhëna të institucionit që kërkohen nga projekti për zbatimin e

treguesve evropianë në nivelin vendor. Bashkia Kamëz nëpërmjet këtij projekti do të ngriejë Këndin e BE-së, i cili do të drejtohet nga Koordinatori Lokal dhe Koordinatori Mbështetës. Në kuadër të vlerësimit të nevojave për trajnim, është plotësuar pyetësori i hartuar në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe Programin Rajonal për Demokraci Vendore (ReLoAD).

Gjithashtu është plotësuar edhe draft-matrica e vlerësimit të ecurisë së zbatimit të proceseve lidhur me integrimin evropian në nivel vendor me 49 objektiva strategjik dhe 215 tregues. Një punë e konsiderueshme e kësaj drejtorie ka qenë korrespondenca me letrë, kërkesa dhe informacione drejtuar donatorëve, institucioneve, shoqatave lidhur me interesat e përbashkëta bashkëpunuese. Ndërkaq, prioritet për vitin 2018 mbetet aplikimi në fonde të ndryshme përfitimi në programe të KE; angazhim maksimal të projektit "Bashkitë për në Evropë" i financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri për ngritjen e Zyrës Evropiane Vendore në Kamëz; organizimi i bashkëpunimeve në arritjen e partneriteteve dhe binjakëzimeve të reja; krijimi i kontakteve, axhendave për takime pune e partneriteti me përfaqësues nga donatorë, zyra kooperimi të ambasadave, shoqëria civile për të ndërtuar ura bashkëpunimi në interes të zhvillimit të qytetit të Kamzës.

Drejtorja e Financës: Rritje e të ardhurave të Bashkisë 15% më shumë në vitin 2017 në krahasim me 2016-ën



Në analizën e punës së Drejtorisë së Financës për vitin 2017 u theksua se Kamza është ndër bashkitë e para që ka miratur buxhetin e 2017-ës, ashtu si edhe në vitin 2016, në një kohë rekord. Ndërkaq, janë rritur të ardhurat rreth 15% në vitin 2017 në krahasim me 2016-ën. Në analizën e vitit 2017 ishin reflektuar edhe detyrat e lëna në analizën e 2016-ës, sidomos në koordinimin me drejtoritë e tjera të Bashkisë. Duhet përmendur se për sa u përket burimeve të financimit, nga viti 2009 e këtej, përqindja e të ardhurave është më e lartë se transferta, duke pasur kështu rritje të të ardhurave nga viti në vit. Edhe burimet e financimit janë rritur. Kurse në lidhje me shpenzimet, përqindja që zënë investimet është rreth 66%. Kanë ardhur duke u ulur shpenzimet për pagat dhe janë rritur ato për investime (jo se janë ulur pagat, por ka ndryshuar raporti i tyre). Ndërkaq, rritja e shpenzimeve për dy ndërmarrjet do të thotë që janë rritur shërbimet për qytetarët. Gjithashtu, nga kjo drejtori janë përpiluar në kohën dhe masën e duhur listëpagesat e ndihmës ekonomike si dhe për personat me aftësi të kufizuara. Për periudhën janar-shkurt është punuar për mblylljen e llogarive dhe hartimin e pasqyrave financiare të bilancit kontabël vjetor 2016, si dhe paraqitja në afat pranë degës së Thesarit. Është hartuar projektbuxheti i vitit 2018 sipas pasqyrave përkatëse në mënyrë të detajuar për çdo tregues të shpenzimeve dhe të ardhurave. Janë kryer regjistrimet në mënyrë kronologjike të veprimeve kontabël në ditarët e bankës, arkës, pagave, shpenzimeve, të ardhurave, të magazinës etj. Është hartuar situacioni progresiv i shpenzimeve dhe i të ardhurave për çdo muaj dhe është paraqitur në degën e Thesarit si brenda afateve përkatëse. Janë dërguar në afatin e caktuar të gjitha evidencat e realizimit të investimeve në ministritë e linjës dhe në Prefekturë. Janë dërguar evidencat përkatëse në afatin e kërkuar pranë INSTAT-it. Një volum të madh pune ka zënë plotësimi i vërtetimeve të ndryshme si dhe i librezave të kontributeve të sigurimeve shoqërore si për punonjësit e arsimi ashtu edhe të administratës së Bashkisë. Është bërë rakordimi i përmuajshëm për punonjësit që operojnë me bileta shërbimi. Është përfunduar inventarizimi i pajisjeve e i materialeve si të Bashkisë ashtu dhe i shkollave. Gjatë gjithë periudhës me degën e Thesarit dhe të bankës të gjitha veprimet janë kryer sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi pa lejuar asnjë tejkalim zëri të shpenzimeve.

Pas prezantimit të analizës nga drejtoria e Financës, znj. Vjollca Smaçi, sekretari i përgjithshëm i Bashkisë, z. Qemal Çejku, falënderoi drejtorinë e Financës për punën e bërë në vitin 2017 dhe pasqyrimin real të saj në materialin e analizës, edhe pse stafi i saj drejtorie ka qenë i cinguar dhe ka nevojë të zgjerohet. Ndërkaq, ai ka sugjeruar që komunikimi dhe koordinimi me drejtoritë e tjera të vijojë edhe këtë vit.

Veprimtaria e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kamëz, performancë pozitive në vazhdimësi

Pikët	Vlerësime/ nga Drejtoria publike
1. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
2. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
3. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
4. Detyrimet e kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
5. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
6. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
7. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
8. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
9. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
10. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
11. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
12. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
13. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
14. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30
15. Miratimi i kësaj i listës për pagat në ditët e duhura	30

Veprimtaria e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kamëz është vlerësuar në vazhdimësi nga auditimet e jashtme dhe ka rezultuar gjithmonë me një performancë pozitive e, konkretisht, nga Ministria e Financave është vlerësuar me pikët maksimale në Raportin e funksionimit të sistemit të KBFP për vitin 2016. Në raportin e publikuar nga Ministria e Financave për elementet e MFK për vitin 2016, Bashkia Kamëz ka rezultuar me performancë të shkëlqyer, duke u renditur në vendin e parë nga 61 bashki. Ndër 15 tregues të vlerësuar, 5 kanë lidhje të drejtpërdrejta me procedurat e auditimit, për të cilat janë marrë pikët maksimale, ndërsa për 5 tregues, të cilët kanë të bëjnë me elementet e MFK, kjo drejtori ka qenë aktor kryesor në hartimin e dokumentacionit (pyetësor vetëvlerësimi, deklaratë cilësie etj.). Kjo ishte një nga arritjet e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, që u theksua gjatë analizës së punës për vitin 2017.

Gjatë vitit që kaloi, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka kryer 10 misione auditimi kundrejt 10 misioneve të programuara ose 100% e planit vjetor. Ndërkohë, numri i subjekteve që nuk janë audituar brenda frekuencës së pranuar (dy vjet), në fund të 2017-ës mbetet 0 subjekte.

Bazuar në konstatimet janë lënë për zbatim rekomandimet, ku përmes dërgimit të rekomandimit në subjektet e audituara, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm realizon funksionin këshillues, si dhe ndihmon për të rritur përgjegjshmërinë e punonjësve, pranimin e përgjegjësive dhe marrjen e masave korrigjuese që ndikojnë në përmirësimin e punës për të ardhmen, gjithmonë duke respektuar pavarësinë.

Po ashtu, gjatë vitit 2017, është hartuar karta e auditimit të brendshëm, e cila sipas standardeve të auditimit, formalizon dhe pozicionon veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe specifikon qëllimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm. Është hartuar rregullorja për hartimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashki. Është hartuar regjistri i sinjalizimit të brendshëm dhe regjistri i kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja si detyrim ligjor i njësisë së auditimit. Ndërkaq, është dhënë një ndihmë e konsiderueshme në identifikimin dhe mbledhjen e debitorëve, duke përditësuar çdo muaj listat, duke sqaruar subjektet debitore për llojin dhe vlerën e debisë, si dhe duke minimizuar abuzimet. Kjo drejtori ka luajtur rolin kryesor në hartimin e gjurmës së auditimit për procedurat e rëndësishme të Bashkisë. Në bashkëpunim me drejtoritë është plotësuar pyetësori i vetëvlerësimit dhe raporti vjetor për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Kamëz si një dokument i rëndësishëm për institucionin.

Analiza e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, progres në punën e bërë gjatë vitit 2017



Drejtorja e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike në Bashkinë Kamëz ka analizuar punën e bërë gjatë vitit 2017. Prezantimi i analizës kishte në qendër të vet krahasimin e detyrave të lëna dhe problematikave në vitin paraardhës me zgjidhjen e tyre, duke dhënë një paraqitje konkrete të punës njëvjeçare të kësaj drejtorie. Nga kjo analizë u theksua progresi i bërë në punën e vitit 2017. Ndër të tjera, nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike janë njoftuar në kohë të gjitha drejtoritë e Bashkisë nëpërmjet shpërndarjeve të Fletoreve zyrtare dhe interpretimit të bazës ligjore, kur ka qenë e nevojshme, sipas rasteve. Është bashkëpunuar në mënyrë dinamike me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, duke filluar që nga dokumentacioni i duhur për dosjen, hartimi i projektvendimeve përkatëse, deri tek përcjellja e tyre për në Prefekturën e Qarkut Tiranë. Është dërguar në mënyrë shkresore e gjithë baza ligjore për sa i përket legjislacionit për pronat publike. Është nxjerrë e gjithë baza ligjore për dhënie me qira apo emfiteozë të pronave të Bashkisë. Është komunikuar me Drejtorinë e MTMP-së dhe Zyrën e Gjendjes Civile për të nxjerrë numrin e familjeve me datë vendosjeje gusht 1991, tetor 1992, familje të cilat kanë qenë përfituese të tokës bujqësore, në mënyrë që të evidentohen ato raste të cilat kanë përfituar në kundërshtim me ligjin. Ndryshe nga vitet e kaluara nga ana e Zyrës Juridike ka pasur një angazhim me të madh për sa i përket zbatimit të paketës fiskale, duke hartuar në zbatim të saj disa projektvendime etj. Në lidhje me avokatinë e institucionit, nga ana e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike janë ndërmarrë disa hapa, si: shkresa drejtuar Këshillit të Ministrave për sa i përket kalimit në pronësi të pyjeve; hartimi i kërkesëpadive për mbrojtjen e të drejtave të cenuara të Bashkisë; hartimi i kërkesave për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit për vjeljen e gjobave të IMT-së; ndjekja me rigorozitet e seancave gjyqësore në mbrojtje të interesave të Bashkisë. Këtë vit ka pasur një përmirësim të situatës për zbatimin me efikasitet të akteve ligjore, duke sjellë një rënie në krijimin e detyrimeve të reja për shpenzime gjyqësore ndaj Bashkisë. Për sa i përket buxhetit, nga ana e Njësisë së Prokurimit janë hartuar në kohë regjistrat e parashikimeve për prokurimet publike.

Kjo drejtori u vlerësua nga ana e sekretarit të përgjithshme të Bashkisë, z. Qemal Çejku, në emër edhe të kryebashkiakut Xhelal Mziu, duke përgëzuar edhe për mënyrën se si e kishin realizuar analizën. Ndërkaq, u rekomandua që të ketë bashkëpunim shumëplanësh akoma më shumë me drejtoritë e tjera të Bashkisë.



Kryebashkiaku Mziu inspekton punimet në rrugën “Gurrë” në lagjen 2 Bathore, një tjetër investim i Bashkisë Kamëz

Viti 2018 ka nisur me një tjetër rekord të Bashkisë Kamëz për sa i përket vëmendjes së saj për investimet publike.

Gjatë këtij viti, Bashkia e Kamëzës do të bëjë investime të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore dhe atë të kanalizimeve.

Sikurse vitin e kaluar, kur Bashkia i kushtoi rëndësi infrastrukturës rrugore dhe kanalizimeve, edhe gjatë vitit 2018, Bashkia e Kamëzës mbi 60% të buxhetit e ka për investimet.

Edhe këtë vit do të jetë prioritet përmirësimi i ndjeshëm i infrastrukturës rrugore në Kamëz dhe



Paskuqan si dhe do të investohet në dhjetëra akse rrugore, me qëllim që qytetarët të përballen me një realitet të ri pas punimeve të kryera në përfundim të realizimit të investimit, i cili do të japë impakt social për ta.

Veç investimeve të reja të Bashkisë Kamëz, do të ketë ndërhyrje në rrugë të dëmtuara në riparim asfaltesh në disa akse rrugore në Kamëz dhe Paskuqan. Shembull për këtë është edhe një prej investimeve të realizuara nga Bashkia, siç është rruga “Gurrë” në lagjen 2 Bathore, që u inspektua nga kryebashkiaku Xhelal Mziu.

Gjatë inspektimit ai premtoi se investimet do të shtohen nga viti në vit.

Rruga “Pjetër Arbnori” në lagjen 1 Bathore



Rruga “Pjetër Arbnori” në lagjen Bathore 1 është një nga dhjetëra investimet e reja që Bashkia Kamëz ka planifikuar për të realizuar në vitin 2018. Ky projekt do të bëhet i mundur falë buxhetit të Bashkisë, i cili është buxheti më i lartë i miratuar në këtë njësi vendore. Rruga “Pjetër Arbnori” në lagjen Bathore 1 ka një gjatësi 300 metra linearë dhe me gjerësi 6 m. Ajo kufizohet nga Bulevardi Blu dhe rruga “Co-Plan”, duke bërë lidhjen e mijëra qytetarëve të kësaj

lagjeje. Duke qenë se ka dalje në Bulevardin Blu, investimi i Bashkisë në këtë segment rrugor merr një rëndësi të veçantë. Për t'u theksuar është fakti se ky investim së bashku me dhjetëra të tjerë që do të realizohen në Kamëz e Paskuqan, financohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë Kamëz. Ky është edhe destinacioni i të ardhurave që mblidhen nga kjo njësi vendore, e cila jo më kot u rendit edhe Bashkia e parë në shkallë vendi për mirëmenaxhimin financiar.

KUN në rrugën “Shkëndija” në Laknas



Ndërhyrja në rrjetin e kanalizimeve në segmentin e rrugës “Shkëndija” në Laknas me gjatësi 1044 metra linearë është një tjetër investim i Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Në këtë projekt do të përdoren tuba me përmasa Ø 600. Buxheti i këtij viti, si buxheti më i madh në të gjitha vitet, përfshin në pjesën dërrmuese të tij financimin për investime. Krahas ofrimit të shërbimeve cilësore për qytetarët në tri njësitë: Kamëz, Bathore e Paskuqan, Bashkia ka ruajtur trendin e saj për të rritur nga viti në vit investimet në infrastrukturën e qytetit. Kështu, së

shpejti do të nisin punimet për ndërtimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura në rrugën “Shkëndija”, në të cilën është investuar më parë nga Bashkia Kamëz, duke bërë asfaltimin e saj. Ky investim, i cili do të realizohet tërësisht me fondet e parashikuara në buxhetin e Bashkisë Kamëz të vitit 2018, ka një rëndësi të madhe sociale e mjedisore. Pas realizimit të këtij investimi situata do të ndryshojë tërësisht, pasi rrjeti i KUN-së, i cili do të ketë parametrat e duhur bashkëkohorë, do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve.

Rruga “Kuvendi i Dibrës” në lagjen 1 Bathore



Banorëve të lagjes 1 Bathore do t'u shtohet edhe një investim tjetër. Bëhet fjalë për rrugën “Kuvendi i Dibrës”, 245 metra linearë e gjatë. Është pikërisht kjo rrugë që do të asfaltohet tërësisht, duke i ardhur në ndihmë një pjese të madhe të komunitetit. Rruga “Kuvendi i Dibrës” përbën një njësi njaft të rëndësishme, sepse bën lidhjen e mijëra qytetarëve të Bathores. Me këtë investim të Bashkisë Kamëz merr zgjidhje edhe problemi i kalimit nëpër këtë rrugë. Përveç banorëve të zonës që lidh kjo rrugë, ajo u shërben edhe nxënësve që të shkojnë

në shkollat përkatëse.

Gjatësia e segmentit rrugor që do të ndërtohet është 245 metra linearë. Financimi i këtij investimi do të bëhet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë, duke qenë se qeveria e majtë nuk ka denjuar që të financojë asnjë projekt me rëndësi jetike për komunitetin, i cili ka më shumë nevojë se asnjë zonë tjetër në vend. Kështu, indiferencës dhe diskriminimit të qeverisë së Edi Ramës Bashkia Kamëz i përgjigjet vetëm me punë, investime publike dhe shërbime cilësore për qytetarët.

KUN në rrugën “Isuf Xhelili” në Paskuqan 2 Kodër



480 metra linearë do të jetë gjatësia e segmentit në rrugën “Isuf Xhelili”, ku Bashkia Kamëz do të ndërtojë rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN). Kjo rrugë shtrihet në lagjen Paskuqan 2 Kodër. Në këtë KUN do të përdoren tuba me përmasa Ø 315 dhe 400. Kujtojmë se pjesa më e madhe e rrugës “Isuf Xhelili” është ndërtuar nga Bashkia Kamëz, me të ardhurat e veta gjatë vitit të kaluar.

Ndërkohë, këtë vit objekt i investimit të Bashkisë është ndërtimi i KUN-së, një nga nevojat e shumta të qytetarëve të Paskuqanit.

Me realizimin e këtij projekti për banorët e zonës merr zgjidhje një problematikë dhe shqetësim lidhur me ndërtimin e infrastrukturës. Meqenëse kërkesat dhe nevojat e komunitetit janë të shumta dhe emergjente, Bashkia Kamëz i është drejtuar për pesë vite rresht qeverisë për financim projektesh, por këto kërkesa kanë rënë në vesh të shurdhër. Duke u gjendur përballë kësaj situatë, Bashkia ka shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme për t'u ofruar qytetarëve të saj investime publike dhe shërbime cilësore.



Përfundojnë punimet te rruga pranë gjimnazit “Isa Boletini”, të cilat i ka inspektuar kryebashkiaku Xhelal Mziu

Kanë përfunduar punimet te rruga pranë gjimnazit “Isa Boletini”, të cilat i ka inspektuar kryebashkiaku Xhelal Mziu.

Ky është një tjetër investim i rëndësishëm që i shtohet Paskuqanit, i financuar tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë Kamëz.

Ndërtimi i kësaj rruge përbën një kontribut të rëndësishëm të Bashkisë për krijimin e një infrastrukture bashkëkohore pranë objekteve arsimore dhe shëndetësore.

Kjo, me qëllimin për të lehtësuar lëvizjen e nxënësve dhe mësuesve përreth kopshteve dhe



si ishte



si është

shkollave, si dhe qytetarëve për të shkuar te qendra shëndetësore. Ky ka qenë edhe një ndër përparësitë e kryebashkiaku Mziu, i cili ka kërkuar që projektet e hartuara të jenë në dobi të të gjithë qytetarëve.

Gjatësia e rrugës përpara gjimnazit “Isa Boletini” në Paskuqan 1 është 100 metra lineare, gjerësia 4 ml, si dhe trotualet në të dyja anët e rrugës me nga 1ml.

Ndërtimi i kësaj rruge, ashtu si edhe të tjera rrugë të tilla në qytetin e Kamzës, lehtëson lëvizjen drejt shkollës dhe qendrës shëndetësore, por shërben edhe për banorët e tjerë të zonës.

Rruga “Zhvillimi” në Valias



Ndërtimi i rrugës “Zhvillimi” në Valias, 610 metra e gjatë dhe me gjerësi 7 metra, është një projekt tjetër madhor i Bashkisë Kamëz për qytetarët e zonës. Ky investim u përket atyre projekteve që janë planifikuar të realizohen me buxhetin e këtij viti. Siç është e ditur tashmë, ky buxhet është më i madhi ndër vite, por kryesorja është se pjesa më e madhe e tij shkon për investime publike, siç është ndërtimi i rrugëve, i rrjetit të kanalizimeve, i rikonstruksionit të shkollave dhe kopshteve.

Ka qenë performanca financiare e Bashkisë që ka bërë të mundur të ardhurat, që do të përdoren për projekte jetike për qytetarët e Kamzës. Kjo është përgjigjja që kjo njësi vendore i jep Kryeministrit dhe qeverisë së tij, që nuk kanë denjuar të financojnë asnjë projekt. Janë rreth 140 projekte që flejnë në sirtarët e ministrive përkatëse, por që nuk e shohin dritën e realizimit të tyre, vetëm se Kamza është qyteti ku ky Kryeministër humbet sistematikisht zgjedhjet.

Ndërtimi i KUN te rruga “Harku i Triumfit” në Valias, një prej investimeve të dobishme që ka realizuar Bashkia Kamëz



Ndërtimi i kanalizimeve te rruga “Harku i Triumfit” në Valias, rreth 460 metra e gjatë, është një prej investimeve të dobishme që ka realizuar Bashkia Kamëz.

Gjatë inspektimit në këtë segment, kryebashkiaku Xhelal Mziu premtoi se së shpejti do të ndërtohet edhe rruga me standarde bashkëkohore.

Rruga “Abdi Bej Toptani” në Valias



Punimet për ndërtimin e rrugës “Abdi Bej Toptani” në Valias, me gjatësi 1400 metra lineare, një prej investimeve të shumta të Bashkisë Kamëz për qytetarët e saj, vijojnë me ritme të kënaqshme. Bashkia po bën realitet një prej projekteve të shumta, me të cilin kishte aplikuar te qeveria shqiptare, por që nuk financoi këtë projekt aq jetik jo vetëm për banorët e zonës, por për të gjithë ata qytetarë që lëvizin në këtë segment. Në kuadër të kërkesave të bëra në vazhdimësi për financim projektesh, Bashkia Kamëz i është drejtuar në mënyrë të përsëritur qeverisë

dhe ministrisë përkatëse për financimin e ndërtimit të rrugës “Abdi Bej Toptani” në Valias, që është mjaft i rëndësishëm për banorët, pasi kjo rrugë përshkon lagjen Valias, duke filluar nga Bulevardi Blu deri në qendër të Valiasit. Gjithashtu, ky segment rrugor mund të shërbejë si unazë e Kamzës nga ana veriore ose si rrugë hyrëse për parashikimin e studimit urban për Valiasin si zonë e rëndësishme industriale. Tashmë ky projekt po realizohet tërësisht nga buxheti i Bashkisë Kamëz, me qëllimin për t’u ofruar qytetarëve të saj një infrastrukturë bashkëkohore.

KUN te rruga “Çorovodë” në lagjen 5 Kamëz



Në vëmendjen e Bashkisë Kamëz është ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve me standarde bashkëkohore. Në këtë kuadër, në vitin 2018 do të ndërtohet edhe KUN në rrugën “Çorovodë”, që ndodhet në lagjen nr. 5 Kamëz. Ky segment rrugor ka një gjatësi prej 225 metrash lineare dhe për ndërtimin e kanalizimeve do të përdoren tuba me përmasa Ø 315. Investimi do të financohet nga të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Kamëz, në të cilin janë planifikuar dhjetëra projekte për

ndërtimin e rrugëve të reja, të kanalizimeve etj. U bënë pesë vite që qeveria e majtë nuk financon asnjë projekt me të cilin ka aplikuar Bashkia gjatë këtyre viteve.

Në mungesë të këtyre fondeve, që do të shkonin për qytetarët e Kamzës, si qytetarë të Shqipërisë, Bashkia është detyruar që të shfrytëzojë çdo burim të ardhurash për të realizuar investime publike, duke qenë përballë një diskriminimi të pashoq nga kjo qeveri dhe ky Kryeministër.



Bursat për studentët, Ministria e Arsimit e nis 2018-ën me një tjetër diskriminim ndaj qytetarëve të Kamzës

Në fillim të vitit 2018, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë akordoi për studentët e Bashkisë Kamëz vetëm 15 (pesëmbëdhjetë) bursa të arsimit të lartë për vitin akademik 2017-2018.

Referuar numrit real të popullsisë në Bashkinë Kamëz, regjistruan 140.000 banorë, e thënë ndryshe, Kamza përfaqëson 5% të numrit të popullsisë në shkallë vendi. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka një numër total të bursave për arsimin e lartë në shkallë vendi 1800 (një mijë e tetëqind). Të ndodhur përpara këtyre fakteve në ndarje matematikore i përkon që Bashkisë Kamëz t'i jepen 90 (nëntëdhjetë) bursa studimore.

Aktualisht ajo ka marrë 6 herë më pak sesa fakti real që Bashkia Kamëz duhej të ishte përfutuese. Edhe në kushtet e dhënies së 90 bursave studimore, përsëri do të kishim një vështirësi në ndarjen e tyre, pasi kërkesa për to është shumë herë më e lartë dhe e vlerësuar sipas kriterëve përfutuese. Jo më tani që për studentët e Bashkisë Kamëz mbeten vetëm 15 bursa studimore dhe



diskriminimi vjen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si një trajtim i vërtetë politik ku të dëmtuar nga ky vlerësim dalin studentët e qytetit të Kamzës.

Ky diskriminim është vazhde e trajtimit të qytetarëve të Kamzës si qytetarë të dorës së dytë.

Prandaj kërkojmë që të rishikohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë edhe një herë numri i bursave studimore akorduar Bashkisë Kamëz për trajtimin e studentëve të këtij qyteti.

Për të gjithë këto i jemi drejtuar me shkresa zyrtare dikasterit përgjegjës të qeverisë shqiptare.

Kamza zhvillon për herë të parë fazën përgatitore në Turqi, falë mbështetjes së kryebashkiakut Mziu

Falë mbështetjes së vazhdueshme dhe të pakursyeshme të kryebashkiakut Xhelal Mziu, ekipi i futbollit të Kamzës zhvilloi fazën përgatitore në Antalia të Turqisë. Kjo është hera e parë që skuadra e Kamzës zhvillon fazën përgatitore për dy fazat e mbetura në Turqi.

Gjithashtu, krahas përgatitjeve për fazat e mbetura, drejtuesit e ekipit kanë punuar edhe në frontin e merkatos për të afruar pranë ekipit lojtarë cilësorë dhe të denjë për skuadrën që të arrihen synimet e vëna në fillim të Kampionatit Kombëtar. Kryebashkiaku Xhelal Mziu në fillim të

Kampionatit Kombëtar pati premtuar që skuadra e Kamzës do të jetë një ekip konkurrues në Superligë, ndërsa objektivi madhor është zona e Evropës. Synimi i parë është arritur, pasi Kamza deri më tani ka zhvilluar një kampionat të shkëlqyer, madje duke u renditur edhe e dyta në tabelën e klasifikimit.

Për të arritur kupat e Evropës skuadra e Kamzës ka zhvilluar përgatitjet intensive në Turqi si dhe drejtuesit kanë premtuar lojtarë shumë cilësorë për të ndihmuar ekipin për të marrë pjesë në Evropë.

Bashkia, bashkëpunimi i frytshëm me donatorë të ndryshëm për realizimin e projekteve në infrastrukturën arsimore



Ndërkaq, risi të punës së Drejtorisë së Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Konvikteve gjatë vitit 2017 ka qenë hartimi i bazës së të dhënave me dosjet e punonjësve të arsimit parashkollor dhe personelit ndihmës; hartimi i bazës së të dhënave të punonjësve të arsimit parauniversitar; hartimi i bazës së të dhënave për sipërfaqen e ndërtesave shkollore dhe trojeve etj.

Në bashkëpunim me Pallatin e Kulturës, Drejtoria e Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Konvikteve është angazhuar në organizimin e një sërë aktiviteteve kulturore me nxënësit e shkollave të Kamzës. Për sa i përket sportit, vlen të përmendet suksesi në futboll i Kamzës, që e mbylli grupin A të Kategorisë së Parë në vendin e parë; u shpall kampione e Kategorisë së Parë; u ngjiti në Superligë; bashkëpunimi i frytshëm midis kreut të Bashkisë, z. Xhelal Mziu, dhe presidentit, z. Naim Qarri, u kurorëzua me ndërtimin e një ekipi konkurrues në Superligë. Synimi i ekipit është të bëhet pjesë e kupave të Evropës. Ndërkohë, bashkëpunimi i shkëlqyer i Bashkisë Kamëz me Federatën Shqiptare të Futbollit bëri të mundur rikonstruksionin e tapetit dhe ambienteve të tjera të stadiumit. Gjithashtu, drejtori i kësaj drejtorie, z. Gani Berisha, përmendi edhe suksese në disiplina të tjera sportive, si në karate, basketboll etj.

Sekretari i përgjithshëm i Bashkisë, z. Qemal Çejku, i cili ndoqi analizën e punës njëvjeçare të Drejtorisë së Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Konvikteve, i përgëzoi për punën e bërë, ku janë gërshetuar arsimit dhe sporti. Ai i përgëzoi edhe në emër të kryebashkiakut Xhelal Mziu, duke vijuar me disa sugjerime për vitin në vijim. Ai propozoi që fokusi të jetë te parashkollorët, aty ka edhe kompetencat Bashkia, duke identifikuar çdo kopsht privat për sa i përket nivelit të stafëve të këtyre kopshteve. Duhet të vijojë edhe për këtë vit bashkëpunimi me organizatat joqeveritare, me bizneset për mbështetje të ndryshme. Në lidhje me aktivitetet z. Çejku sugjeroi që ato të jenë specifike, si për shembull për fëmijët në nevojë, kjo në bashkëpunim me shkollat dhe shoqata të ndryshme.

Drejtorja e Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Konvikteve ka zhvilluar analizën e punës së saj për vitin 2017, në praninë e sekretarit të përgjithshëm të Bashkisë, z. Qemal Çejku. Gjatë prezantimit të analizës u theksua se puna e Drejtorisë së Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Konvikteve për vitin 2017 është bazuar në disa prioritetet siç është bashkërendimi i punëve me Zyrën Arsimore, me drejtuesit e shkollave të Bashkisë Kamëz si dhe me drejtoritë përkatëse në Bashki, si: Drejtoria e Financës, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, Ndërmarrja e Pastrim-Gjellbërimit për ndërhyrjet e nevojshme në përmirësimin e infrastrukturës së shkollave, për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimor.

Gjatë vitit 2017, kjo drejtori ka qenë koherente me të gjitha problematikat infrastrukturore, që shkollat dhe kopshtet kanë pasur, si dhe ka reaguar me aktorët e lartpërmendur për zgjidhjen e tyre në kohë.

Bashkëpunimi i frytshëm me shoqatën "Word Vision" si dhe donatorë të ndryshëm në fushën e biznesit ka bërë të mundur realizimin e dy projekteve në infrastrukturën arsimore të Bashkisë Kamëz: kompleksi sportiv pranë shkollës "Halit Coka dhe rikonstruksioni tërësor i tualeteve në kopshtin "Hillary Clinton". Bashkia Kamëz nga ana e saj investoi fuqishëm në dy objekte sportive: rikonstruksioni i palestrës së lojërave me dorë dhe rikualifikimi i stadiumit të Kamzës.

Drejtorja e Arsimit dhe Sportit ka pasur një bashkëpunim ndërsektorial shumë efikas me të gjitha drejtoritë dhe ndërmarrjet e Bashkisë Kamëz. Kujtojmë që Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë akordoi vetëm 15 bursa të arsimit të lartë për vitin akademik aktual, duke vijuar diskriminimin ndaj qytetarëve të Kamzës.

Drejtorja e Medias dhe Informimit në Bashkinë Kamëz, një dritare komunikimi e hapur dhe transparente



Drejtorja e Medias dhe Informimit ka qenë për vitin 2017 një dritare komunikimi e hapur dhe transparente me aktorët e shumtë të një shoqërimi të grupeve të interesit, duke i dhënë kështu institucionit të Bashkisë vlerën e një qeverisjeje vendore të pakrahueshme, e cila ka shkuar paralelisht me punën e shkëlqyer të institucionit në zhvillimin e qytetit të Kamzës. Kjo ishte një pjesë e shkëlqyer nga analiza vjetore e punës së kësaj drejtorie për vitin 2017. Njëpërmjet kësaj drejtorie zhvillimet e Bashkisë Kamëz kanë qenë të pranishme në mediat qendrore, të shkruara dhe audio-vizive, kjo edhe falë ecurisë dhe performancës së saj, si një nga bashkitë shembull për zhvillimin në fusha të ndryshme dhe për praktikën më të mira të qeverisjes vendore. Viti 2017 solli si risi përmirësimin e disa standardeve në fushën e materializimit të publikimeve. Janë rritur kapacitetet e publikimeve të lajmeve të ilustruara me foto, duke mbetur edhe përgjatë këtij viti një burim i rëndësishëm komunikimi me aktorët e shumtë që ndjekin zhvillimet e

Bashkisë Kamëz, duke pasqyruar gjerësisht serinë e lajmeve dhe albumeve të fotove në faqet zyrtare në to, kjo për shkak të vetë arrijveve të Bashkisë. Ilustrimi i lajmeve të klasifikuara të rëndësishme për vitin 2017, duke përfshirë investimet si dhe të gjitha veprimtaritë e tjera janë pasqyruar nëpërmjet publikimeve me video, si një instrument i rëndësishëm i pasqyrimit të ngjarjeve e veprimtarive të Bashkisë dhe të kryebashkiakut, z. Xhelal Mziu.

Pasqyrimi i lajmeve të Bashkisë në portalet online mbetet një prej arrijveve për vitin 2017. Ndërkaq, marrëdhëniet me mediat qendrore kanë ndikuar pozitivisht në pasqyrimin real të imazhit të Bashkisë Kamëz. Bashkëpunimi me televizionet më prestigjioze të rrjetit mediatik si dhe emisionet investigative këtë vit ruajtën njëjtin trend, duke u kthyer në një partner i rëndësishëm dhe i besueshëm për këto lloje emisionesh dhe njëkohësisht duke ndryshuar perceptimin e mediave dhe të publikut për Bashkinë Kamëz.

Pas prezantimit të analizës nga ana e drejtorit të Medias dhe Informimit, z. Artan Dervishi, ishte sekretari i përgjithshëm i Bashkisë, z. Qemal Çejku, që shprehu vlerësimet dhe sugjerimet e tij për punën e kësaj drejtorie, duke i falënderuar punonjësit e saj edhe në emër të kryetarit Bashkisë, z. Xhelal Mziu. Gjithashtu, ai propozoi edhe disa risi për sa i përket punës në administrimin e faqes zyrtare në web, pasurimin e mëtejshëm të gazetës "Kamza" me rubrika të reja e gjithëpërfshirëse etj.

Bashkëbisedim në kuadrin e hartimit të planit social në Bashkinë Kamëz



Në mjediset e sallës së Këshillit Bashkiak në Bashkinë Kamëz u zhvillua një bashkëbisedim në kuadrin të hartimit të planit social në këtë Bashki. Ky bashkëbisedim u organizua nga Bashkia Kamëz

në bashkëpunim me shoqatën "World Vision". Qëllimi i këtij bashkëbisedimi është identifikimi i nevojave të familjeve dhe qytetarëve të Kamzës. Për këtë shoqata "World Vision" ka kontaktuar me kompaninë "ESA Consulting". Plani synon që të identifikojë problematikat dhe sfidat afatgjata në aspektin social për qytetarët e Kamzës. Fillimisht janë realizuar intervista me punonjësit socialë në Bashki, më pas janë realizuar edhe intervista me OJF të ndryshme, ndërkaq hapi i radhës do të jenë intervistat me qytetarët. Shoqatat që mermin pjesë në këtë aktivitet janë: "Olive Charity", "Caritas", "World Vision", "Të Ndryshëm dhe të Barabartë".